

Liria akademike dhe autonomia institucionale: Fjalët duhen ndjekur nga veprat

Deklaratë e përbashkët nga ALLEA, EUA dhe Science Europe

Prill 2019

Shoqëria moderne zhvillohet nëpërmjet përparimit të dijes, të teknologjisë dhe të zbulimeve shkencore. Që nga barnat, të cilat shpëtojnë jetë, e deri te një njohje më e thellë e sjelljes dhe e komunikimit njerëzor, puna kërkimore teorike dhe ajo e zbatuar ndikojnë dhe sjellin të mira për shoqëritë kudo në botë.

Por, që puna kërkimore ta sjellë këtë kontribut për një të ardhme të suksesshme dhe të qëndrueshme, duhen ndërmarrë një sërë veprimesh sipas disa parimeve themelore. Që të përparojnë dijen, studiuesit kanë nevojën e lirisë së të menduarit, të hulumtimit, ashtu si dhe lirinë e të komunikuarit të rezultateve të punës së tyre dhe edukimit kritik të brezave të ardhshëm. Këto parime bashkohen në një të vetëm: *liria akademike*, e cila duhet zbatuar për të gjithë komunitetin e përfshirë në punë kërkimore, mësimdhënie e edukim. Kjo mbështetet nga autonomia institucionale, e cila mbron arsimin e lartë dhe institucionet kërkimore nga ndërhyrjet politike e ekonomike dhe siguron vetëqeverisjen e komunitetit shkencor.

Të gjitha vendet e Europës, me anë të legjislacioneve kombëtare, marrëveshjeve ndërkombëtare apo Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, si dhe shumë vende të tjera rreth botës, kanë dispozita ligjore që sigurojnë lirinë akademike dhe autonominë institucionale. Edhe pse mjetet ligjore kanë dallime në qëllim dhe përmbajtje, ato reflektojnë një zotim të përbashkët për t'i mbrojtur këto parime. Megjithatë, pavarësisht këtij zotimi, liria akademike dhe autonomia institucionale e kanë humbur forcën e tyre në Europë apo në botë, duke sjellë pasoja të rënda për studiuesit, shkencën dhe shoqërinë.

Të gjitha akademitë europiane (ALLEA), Shoqata Europiane e Universiteteve (EUA) dhe Science Europe, të cilat përfaqësojnë një sektor të madh të punës kërkimore europiane dhe sistemit të arsimit të lartë, përsërisin se liria akademike dhe autonomia institucionale kanë rëndësi dhe vlerë thelbësore për shoqërinë dhe u bëjnë thirrje:

- qeverive dhe autoriteteve publike që të mbrojnë lirinë akademike dhe të ruajnë autonominë institucionale të arsimit të lartë dhe të institucioneve kërkimore nëpërmjet sistemeve rregullatore të qarta dhe të qëndrueshme, pa ndërhyrje në çështjet e tyre të brendshme dhe me dialog të vazhdueshëm e të bazuar në mirëbesim me sektorin;
- qeverive dhe autoriteteve publike që t'u sigurojnë studiuesve dhe studentëve të drejtat që përbëjnë lirinë akademike, si: liria e të shprehurit, e opinionit, e mendimit, e informacionit dhe e grupimit ashtu si dhe e drejta për edukim e mësimdhënie;

- qeverive dhe autoriteteve publike të sigurojnë autonominë e vendimeve të këshillave kërkimore dhe organeve financuese lidhur me financimin, si dhe shumëllojshmërinë e punës kërkimore që financohet. Edhe pse financimi mund të bazohet në prioritetin e punës kërkimore, asnjë disiplinë nuk mund të përjashtohet për shkak të arsyeve politike;
- universiteteve, agjencive që mundësojnë fonde, akademive dhe organizatave të tjera kërkimore që të sigurojnë se të gjithë studiuesit, mësuesit dhe studentët të kenë liri akademike, duke nxitur një kulturë në të cilën liria e të shprehurit dhe shkëmbimi i hapur i opinioneve të vlerësohen dhe të mbrojnë komunitetin kërkimor dhe mësimdhënës nga sanksionet për ushtrim të lirisë akademike.

Organizatave që kanë firmosur deklaratën pranojnë se liria akademike dhe autonomia institucionale kanë një qëllim të rëndësishëm. Roli i tyre është të mundësojnë që institucionet kërkimore dhe ato të arsimit të lartë të përballojnë përgjegjësitë e tyre ndaj shoqërisë. Liria akademike duhet të mbështetet mbi standarde të rrepta shkencore dhe profesionale, respekti për të drejtat e të tjerëve, sjellje etike dhe ndërgjegjësimi për ndikimin që ka puna kërkimore mbi njeriun dhe mjedisin që e rrethon. Institucionet autonome kërkimore dhe ato të arsimit të lartë duhet të mbajnë përgjegjësi ndaj komuniteteve të tyre, organeve publike dhe ndaj shoqërisë. Qeveritë luajnë një rol kyç në nxitjen e kësaj. Ne besojmë se liria akademike dhe autonomia institucionale, së bashku me një ndërgjegjësim ndaj përgjegjësisë dhe arritjes së qëllimeve, u lejojnë institucioneve kërkimore dhe atyre të arsimit të lartë, si dhe shoqërive të cilave ato u shërbejnë, të shfaqin potencialin e tyre të plotë.